

Vendim nr. 285 datë 27.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: DED JAKAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4634, datë 09.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 49, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me urdhrin nr. 251, datë 20.07.2007, kërkuesi Ded Jakaj (*kërkuesi*) ka filluar marrëdhënien e punës pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), palë e paditur, duke u emëruar “specialist” në sektorin e aksesit dhe interkoneksionit pranë Drejtorisë së Rregullimit të Tregut. Marrëdhëniet e tij financiare me AKEP-in kanë filluar në datën 23.07.2007, datë në të cilën është lidhur kontrata e punës me afat 3-mujor. Ndërkohë, në datën 23.10.2007, pas përfundimit të periudhës 3-mujore të provës, ndërmjet kërkuesit dhe AKEP-it është lidhur kontrata e punës me afat 1-vjeçar dhe më tej, në datën 14.05.2008, është lidhur kontrata e punës me afat të pacaktuar.

2. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar (*ligji nr. 152/2013*), Kuvendi, me vendimin nr. 11, datë 20.02.2014, ka miratuar strukturën e re të AKEP-it. Kjo e fundit, me shkresën nr. 660, datë 20.03.2014, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike (DAP) për procedurën që duhet të zbatonte në implementimin e strukturës së re. DAP-i, me shkresën nr. 1043, datë 14.04.2014, ka sqaruar AKEP-in se për implementimin e strukturës së re duhet të mbahen parasysh parashikimet e ligjit nr. 152/2013, konkretisht kërkesat e neneve 22, 23, 25, 26 në lidhje me pranimin në shërbimin civil, si dhe kërkesat e neneve 49, 50, 51 dhe 52.

3. Me urdhrin nr. 1150, datë 29.04.2014, AKEP-i ka ngritur komisionin e ristrukturimit dhe verifikimit të statusit të nëpunësve civilë, i cili, me shkresën nr. 1535, datë 13.06.2014, i ka propozuar titullarit të AKEP-it lirim nga detyra të kërkuesit, pasi nuk kishte përputhshmëri me kriteret specifike të vendeve të lira të krijuara dhe me kriteret që plotësojnë nëpunësit sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë arsye, kryetari i AKEP-it, me vendimin nr. 1227, datë 13.06.2014 (*vendimi nr. 1227/2014*), në mbështetje të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 9918/2008, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 9918/2008*) dhe Kodit të Punës (KP), ka vendosur lirim nga detyra të kërkuesit.

4. Në datën 17.06.2014 kërkuesi i është drejtuar AKEP-it dhe komisionit të ristrukturimit për risistemimin e tij në një nga pozicionet e lira në institucion. Me shkresën nr. 1535/5, datë 25.06.2014, AKEP-i i ka kthyer përgjigje duke u shprehur, ndër të tjera, se zgjidhja e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit është përcaktuar në nenet 12 e 13 të kontratës individuale të punës. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me sa më sipër, në datën 11.07.2014 i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 1227/2014 të kryetarit të AKEP-it; detyrimin e këtij të fundit ta kthejë atë në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend pune paralel; detyrimin e AKEP-it t’i paguajë kërkuesit

pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin në vendin e punës; detyrimin për pagimin e shpenzimeve gjyqësore.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5470, datë 07.10.2014, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Shfuqizimin e vendimit nr. 1227/2014. Detyrimin e AKEP-it të kthejë paditësin (kërkuesin) në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori. Detyrimin e AKEP-it t’i paguajë paditësit (kërkuesit) pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin në vendin e mëparshëm [...]”.

6. Sipas Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga ana e palës së paditur është zbatuar në mënyrë të gabuar neni 67 i ligjit nr. 152/2013 dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013” (*VKM nr. 116/2014*). Sipas asaj gjyqate, njësia përgjegjëse e verifikimit të procedurës së punësimit, komisioni i ristrukturimit, duhet të verifikonte nëse paditësi (kërkuesi) ka qenë i punësuar mbi bazën e një procedure konkurrimi apo ishte i punësuar në atë pozicion për jo më pak se një vit dhe pas këtij verifikimi duhet të deklaronte statusin e punësimit. Për këtë arsye, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se vendimmarrja e palës së paditur (AKEP-it) për lirim nga detyra të paditësit (kërkuesit) nuk është e bazuar në asnjë prej dispozitave ligjore që normojnë marrëdhënien e punës. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nga AKEP-i është përdorur si bazë ligjore KP-ja, ndërkohë që marrëdhënia e punës së paditësit (kërkuesit) rregullohet nga ligji nr. 152/2013 dhe titullari i AKEP-it nuk ka asnjë kompetencë ligjore të zgjidhë kontratën e punës.

7. Mbi ankimin e AKEP-it, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4215 (1054), datë 05.12.2016, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 5470 datë 07.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin e pjeshëm të padisë. Detyrimin e AKEP-it t’i paguajë paditësit (kërkuesit) në total një dëmshpërblim prej 14 (katërmëdhjetë) pagash mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës, mosrespektimit të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës, mosrespektimit të procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës, si edhe vjetërsisë në punë.”.

8. Në vlerësimin e saj, Gjykata Administrative e Apelit, ndër të tjera, ka arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të KP-së, ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), dhe provave të administruara në gjykim. Sipas gjykatës së apelit, vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë se

marrëdhënia e punësimit të paditësit (kërkuesit) rregullohet nga ligji për nëpunësin civil është i pabazuar, pasi nuk është administruar asnjë provë që të vërtetojë faktin se paditësi gëzon statusin e nëpunësit civil, si edhe nuk rezulton të jetë bërë deklarimi i statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse. Gjithashtu, gjykata e apelit ka arsyetuar se ndodhet përpara një marrëdhënieje juridike pune, e cila rregullohet nga dispozitat e KP-së. Në vlerësimin e gjykatës së apelit, në analizë të nenit 153, pika 1, të KP-së, nuk janë vërtetuar raste kur pala paditëse (kërkuesi) të ketë shkelur detyrimet kontraktuale me faj të rëndë apo raste kur ka shkelur detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të palës së paditur. Në këto rrethana, gjykata e apelit ka vlerësuar se motivacioni i largimit nga puna për shkak ristrukturimi nuk plotëson kushtet kumulative për të pranuar ekzistencën e shkakut të justifikuar, sipas nenit 153 të KP-së dhe për pasojë ndodhet përpara zgjidhjes së menjëhershme, pa shkaqe të justifikuara të kontratës individuale të punës me afat të pacaktuar dhe pa zbatuar procedurën dhe afatin e njoftimit.

9. Mbi rekursin e kërkuesit dhe AKEP-it, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4634 (380), datë 09.11.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë. Sipas Kolegjit Administrativ, nuk parashtrihen çështje ligjore të panjohura për palët ndërgjyqëse, përkundrazi ato kanë qenë pjesë integrale e debatit gjyqësor midis tyre, referuar përmbajtjes së akteve procedurale. Ndërsa në vlerësimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, duke e çmuar të drejtë vlerësimin e gjykatës së apelit se marrëdhënia e punës ndërmjet palëve rregullohej sipas dispozitave të KP-së dhe jo sipas ligjit nr. 152/2013.

10. Për sa i përket rekursit të paraqitur nga AKEP-i, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se ai përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, të cilat e bëjnë të cënueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se gjykata e apelit, pasi ka arritur në përfundimin se pala paditëse nuk gëzon statusin e nëpunësit civil dhe marrëdhënia e punësimit midis palëve ndërgjyqëse rregullohet prej KP-së, ka vendosur kryesisht, pa pasur kërkim nga pala paditëse, për zbatimin e neneve 143, 144, 145, 153 dhe 155 të KP-së. Sipas atij kolegji, edhe përmbajtja e rekursit të paditësit tregon qartë se padia e tij i mbështet kërkimet në ligjin nr.152/2013. Në vlerësimin e Kolegjit Administrativ, Gjykata Administrative e Apelit nuk mund të shprehej tej kërkimeve në padi dhe objektit të ankimit që e kanë vënë në lëvizje atë, si edhe nuk mund të shprehej kryesisht për pasojat e zgjidhjes së kontratës së punës pa disponimin maksimal dhe ekskluziv në padi nga ana e paditësit punëmarrës. Po ashtu, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se gjykata e

apelit nuk mund të caktojë vetë se cilat dëmshpërblime duhet të përfitojë paditësi sipas KP-së, ndërkohë që vetë ai nuk i kërkon ato, dhe se po ai nuk ka qenë dakord me vendimin e gjykatës së apelit duke ushtruar rekurs referuar një shkaku tjetër ligjor dhe duke u qëndruar pretendimeve të tij se gëzon statusin e nëpunësit civil.

11. Në datën 09.09.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 27.09.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

12.1. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në rastin konkret ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga praktika e tij e mëparshme e mbajtur me vendimet nr. 00-2022-2210, datë 06.10.2022, nr. 00-2023-5545, datë 17.11.2023, si edhe nr. 00-2022-4208, datë 22.12.2022. Edhe në këto raste, paditësit i kanë bazuar pretendimet e tyre në ligjin nr. 152/2013, ndërsa gjykatat më të ulëta e kanë bazuar vendimmarrjen në dispozitat e KP-së, ndërkohë që Gjykata e Lartë nuk ka gjetur shkelje.

12.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur tej shkaqeve të ngritura në rekurs nga palët. Në rastin konkret asnjë nga palët nuk ka ngritur pretendime se Gjykata Administrative e Apelit nuk kishte të drejtë për të disponuar bazuar në dispozitat e KP-së. Shkaqet e ngritura në rekurs nga AKEP-i nuk kanë asnjë lidhje me disponimin e Kolegjit Administrativ. Për rrjedhojë, ai kolegji nuk duhej të dispononte me rrëzim padie, bazuar në një argument që nuk e ka pretenduar asnjë palë në proces.

12.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, duke kryer një interpretim të ndryshëm të ligjit nga gjykatat më të ulëta dhe duke u shprehur për çështje që dilnin përtej shkaqeve të rekursit dhe përtej asaj çka ishte diskutuar në ato gjykata, pa i dhënë mundësinë kërkuesit që të shprehte mendimin e tij për to.

- 12.4. *Së drejtës së aksesit të lidhur me parimin e sigurisë juridike*, pasi në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka keqinterpretuar dhe nuk ka zbatuar vendimin unifikues nr. 3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në këtë rast, Kolegji Administrativ nuk ka arsyetuar se pse disponimi i gjykatës së apelit përbën ndryshim nga shkaku i padisë dhe jo thjesht ndryshimin e bazës ligjore, kur në fakt mosmarrëveshja ndërmjet palëve lidhej me ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës me AKEP-in. Edhe nëse baza ligjore e cituar nga kërkuesi ishte e gabuar, gjykatat nuk kanë ndalim që ta orientojnë dhe/ose disponojnë sipas bazës ligjore që ato vlerësojnë si të duhurën.
- 12.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe i paarsyetuar. Në paragrafin 18 të vendimit të tij, Kolegji Administrativ shprehet se “[...] nuk parashtrohen çështje ligjore të panjohura për palët ndërgjyqëse, përkundrazi ato kanë qenë pjesë integrale e debatit gjyqësor midis tyre, referuar përmbajtjes së akteve procedurale [...]”. Ndërkohë, në paragrafin 30 të vendimit të tij Kolegji Administrativ shprehet se “[...] Gjykata Administrative e Apelit nuk mund të shprehet tej kërkimeve në padi dhe objektit të ankimit që ka vënë në lëvizje këtë gjykatë [...]”. Duke analizuar këta dy paragrafë konstatohet se vendimi i Kolegjit Administrativ është kontradiktor. Gjithashtu, vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i mangët në arsytimin e tij, pasi nuk ka arsyetuar pse pretendimet e kërkuesit nuk bëjnë pjesë në fushëveprimin e Gjykatës së Lartë, cilat janë pretendimet e tij që lidhen me vlerësimin e provave dhe pse është i drejtë vlerësimi i gjykatës së apelit dhe jo ai i gjykatës së shkallës së parë lidhur me ligjin e zbatueshëm. Në këtë rast Kolegji Administrativ nuk ka arsyetuar se pse disponimi i gjykatës së apelit përbën ndryshim nga shkaku i padisë dhe jo thjesht ndryshimin e bazës ligjore, kur në fakt mosmarrëveshja ndërmjet palëve lidhej me ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës me AKEP-in.
- 12.6. *Së drejtës për punë*, për shkak të mënyrës së interpretimit nga ana e Gjykatës së Lartë të dispozitave të ligjit nr. 152/2013 dhe KP-së. Kërkuesi ishte nëpunës civil *ipso lege* dhe ky qëndrim është mbajtur edhe nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa sipas gjykatës së apelit marrëdhënia rregullohej nga KP-ja. Në kuptim, çështja ligjore nuk ishte e thjeshtë për t’u interpretuar nga vetë kërkuesi, për sa kohë largimi i tij nga pozicioni është kryer vetëm pak kohë pas hyrjes në fuqi të

ligjit nr. 152/2013 dhe rrjedhimisht nuk kishte asnjë mundësi objektive, përveç interpretimit të tij, se ku të mbështeste padinë. Edhe nëse përcaktimi prej tij i bazës ligjore do të ishte i gabuar, Gjykata e Lartë do të duhej të merrte një vendim të tillë që të mos cenonte të drejtën e tij për punë dhe të drejtën e pronës. Në këtë rast, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë mundësi palëve të shprehen lidhur me përcaktimin e ri juridik që ka bërë lidhur me dispozitat ligjore të përzgjedhura. Gjykata e Lartë e ka barazuar shkakun e padisë me bazën ligjore të përcaktuar në padi, çka nga praktika e unifikuar e saj është e pasaktë. Me arsyetimin e saj Gjykata e Lartë i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Në këtë këndvështrim, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

16. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i

kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 09.11.2023, i cili, sipas informacionit të sjellë nga Gjykata e Lartë në datën 24.10.2024, është bërë i disponueshëm për palët në datën 09.05.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 09.09.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra brenda afatit 4-mujor.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për punë, për shkak të mënyrës së interpretimit nga ana e Gjykatës së Lartë të dispozitave të ligjit nr. 152/2013 dhe KP-së. Sipas kërkuuesit, ai ishte nëpunës civil *ipso lege* dhe ky qëndrim është mbajtur edhe nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa sipas gjykatës së apelit marrëdhënia rregullohej nga KP-ja. Në këtë kuptim, sipas tij, çështja ligjore nuk ishte e thjeshtë për t'u interpretuar prej tij, për sa kohë largimi nga pozicioni është kryer vetëm pak kohë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 dhe rrjedhimisht nuk kishte asnjë mundësi objektive se ku të mbështeste padinë, përveç interpretimit të tij. Gjithashtu, kërkuuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit dhe parimit të sigurisë juridike, duke argumentuar se në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka keqinterpretuar dhe nuk ka zbatuar vendimin unifikues nr. 3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në drejtim të këtyre pretendimeve kërkuuesi ka argumentuar se edhe nëse baza ligjore e cituar prej tij ishte e gabuar, gjykatat nuk kanë ndalim që ta orientojnë dhe/ose disponojnë sipas bazës ligjore që ato vlerësojnë si të duhurën. Në vlerësimin e kërkuuesit është cenuar edhe parimi i barazisë përpara ligjit, pasi sipas tij Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në rastin konkret ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga praktika e tij e mëparshme,

18. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj, kur kërkuuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën se si gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, ka theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete

është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa më sipër, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të pretendimeve të tij për cenimin e *së drejtës për punë, së drejtës së aksesit dhe parimit të sigurisë juridike*, Kolegji vëren se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të interpretimit e zbatimit të ligjit dhe, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Ndërsa, për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, referuar edhe jurisprudencës kushtetuese për raste të ngjashme, Kolegji evidenton se kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument konkret dhe nuk ka arritur të provojë nga pikëpamja kushtetuese pretendimin e tij në këtë drejtim, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se këto pretendime të kërkuesit nuk janë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese.

21. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, Kolegji konstaton se ai ka argumentuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës është shprehur tej shkaqeve të ngritura në rekurs nga palët, për çështje të ligjit, marrë kryesisht prej tij, dhe për të cilat ata nuk kanë paraqitur më parë mendim, në kundërshtim me nenin 473/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si edhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Administrativ ka dhënë një vendim të paarsyetuar dhe kontradiktor.

22. Për sa më lart, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë thelbin e këtyre pretendimeve, do t'i analizojë ato në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, si aspekte të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Si të tilla ato, *prima facie*, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues ndaj do të shqyrtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

23. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës është shprehur tej shkaqeve të ngritura në rekurs nga palët, për çështje të ligjit, marrë kryesisht prej tij, dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendim, në kundërshtim me nenin 473/a të KPC-së

24. Gjykata ka pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit

në gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Sipas nenit 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit të rekursit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtrësive të tyre për çështjet e ligjit. Në këtë kuptim, Gjykata është shprehur se palëve duhet t'u jepet mundësia të paraqesin paraprakisht mendimin e tyre për çështjet ligjore të analizuara kryesisht nga ajo gjykatë në mënyrë që t'u garantohet efektivisht e drejta e aksesit (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 7, datë 21.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar me këtë ankim kushtetues individual është nisur nga kërkuesi nëpërmjet kërkesëpadisë me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 1227/2014 të kryetarit të AKEP-it dhe detyrimin e këtij të fundit ta kthejë atë në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend pune paralel, duke i paguar pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin në vendin e punës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se nga ana e palës së paditur është zbatuar në mënyrë të gabuar neni 67 i ligjit nr. 152/2013 dhe VKM-ja nr. 116/2014. Sipas asaj gjykate, nga AKEP-i është përdorur si bazë ligjore KP-ja, ndërkohë që marrëdhënia e punës së paditësit (kërkuesit) rregullohej nga ligji nr. 152/2013. Mbi ankimin e AKEP-it, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se ai është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të KP-së, ligjit nr. 49/2012 dhe provave të administruara në gjykim, pasi jemi përpara një marrëdhënie juridike pune, e cila rregullohej nga dispozitat e KP-së. Në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit ka vendosur se AKEP-i duhet t'i paguajë kërkuesit në total një dëmshpërblim prej 14 (katërmëdhjetë) pagash mujore.

27. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit kanë bërë recurs kërkuesi dhe AKEP-i. Sipas pretendimeve të kërkuesit të paraqitura në recurs, vendimi i gjykatës së apelit është marrë në interpretim të gabuar të ligjit, pasi marrëdhënia e tij e punës, referuar nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, rregullohej nga ky i fundit, ndërsa sipas AKEP-it, bazuar në nenin 115 të ligjit nr. 9918/2008, marrëdhëniet e punës rregulloheshin sipas dispozitave të KP-së.

28. Në vlerësimin e shkaqeve të rekurseve, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka evidentuar në vendimin e tij se nuk parashtrihen çështje ligjore të panjohura për palët

ndërgjyqëse, por se përkundrazi ato kanë qenë pjesë integrale e debatit gjyqësor midis tyre, ka arsyetuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, duke e vlerësuar të drejtë vlerësimin e gjykatës së apelit se marrëdhënia e punës rregullohej sipas dispozitave të KP-së dhe jo sipas ligjit nr. 152/2013. Ndërsa, për sa u përket shkaqeve të rekursit të paraqitur nga AKEP-i, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se gjykata e apelit, edhe pse ka arritur në përfundimin se pala paditëse (kërkuesi) nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil dhe marrëdhënia e punësimit midis palëve ndërgjyqëse rregullohej prej KP-së, ka vendosur kryesisht, pa pasur kërkim prej tij (kërkuesit), për zbatimin e dispozitave të KP-së. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit është shprehur tej kërkimeve të paraqitura në padi dhe objektit të ankimit që e ka vënë në lëvizje atë, duke u shprehur për pasojat e zgjidhjes së kontratës së punës pa disponimin e kërkuesit.

29. Nisur nga sa më lart, në rastin konkret, Kolegji vëren se nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë qenë në dijeni ose nuk kanë pasur mundësinë të debatonin apo të jepnin mendimin e tyre më parë, përkundrazi rezulton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar njësoj si gjykata e apelit, se marrëdhënia e punës ndërmjet kërkuesit dhe AKEP-it rregullohej nga dispozitat KP-së, por e ka ndryshuar vendimin e asaj gjykate, për shkak se ajo ishte shprehur për kërkesa të pangritura në ankim. Po kështu, Kolegji konstaton se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrim të kompetencës së tyre, kanë analizuar çështjen në drejtim të ligjit të zbatueshëm, i cili ishte një ndër shkaqet e rekursit të palëve, që është vlerësuar edhe nga Gjykata e Lartë.

30. Bazuar në këto konsiderata, Kolegji evidenton se kërkuesi ka pasur mundësi të paraqiste paraprakisht mendimin e tij për çështjet ligjore të analizuara nga Gjykata e Lartë, duke iu garantuar efektivisht e drejta e aksesit. Për rrjedhojë, pretendimi i tij se Gjykata e Lartë është shprehur për çështje të ligjit, të cilat janë marrë në shqyrtim kryesisht prej saj, pa njoftuar më parë palët për to, sipas nenit 473/a të KPC-së, është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

31. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ ka dhënë një vendim kontradiktor, referuar paragrafëve 18 dhe 30 të tij dhe nuk ka arsyetuar pse disponimi i gjykatës së apelit përbën ndryshim nga shkaku i padisë dhe jo thjesht ndryshimin e bazës ligjore.

32. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element

thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 12, datë 28.02.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë, i qartë dhe jo kontradiktor në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 41, datë 29.05.2024; nr. 12, datë 28.02.2024; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i standardit të arsyetimit të vendimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Duke iu rikthyer rastit konkret, lidhur me paragrafin 18 të Kolegjit Administrativ, për të cilin ka ngritur pretendimin kërkuesi, konstatohet se sipas atij kolegji pala rekursuese ka parashtruar shkaqe në rekurs, të cilat i janë njoftuar palës tjetër ndërgjyqëse dhe kjo e fundit nuk rezulton të ketë paraqitur kundërrekurs. Po sipas atij kolegji, nuk rezulton që palët të kenë depozituar qëndrim me shkrim para shqyrtimit, dhe për këtë arsye ka vlerësuar se nuk parashtrohen çështje ligjore të panjohura për palët ndërgjyqëse, përkundrazi ato kanë qenë pjesë integrale e debatit gjyqësor midis tyre. Ndërsa për sa i përket paragrafit 30 të vendimit të Kolegjit Administrativ, ky i fundit, ndër të tjera, ka arsyetuar se gjykata e apelit nuk mund të shprehet tej kërkimeve në padi dhe objektit të ankimit që e ka vënë në lëvizje atë, si edhe nuk mund të shprehet kryesisht për pasojat e zgjidhjes së kontratës së punës pa disponimin maksimal dhe ekskluziv në padi nga ana e paditësit punëmarrës. Po ashtu, në këtë paragraf (30) Kolegji Administrativ ka arsyetuar se gjykata e apelit nuk mund të caktojë vetë se cilat dëmshpërblime duhet të përfitojë paditësi sipas KP-së, ndërkohë që vetë ai nuk i ka kërkuar ato.

34. Nisur nga sa më lart, Kolegji konstaton se në vlerësimin e tij Kolegji Administrativ në paragrafin 18 të vendimit ka arsyetuar lidhur me shqyrtimin e çështjes prej

tij në drejtim të shkaqeve të rekursit, të cilat u janë bërë të njohura palëve, ndërsa në paragrafin 30 ka arsyetuar në lidhje me vlerësimin që i ka bërë vendimmarrjes së gjykatës së apelit, e cila sipas Kolegjit Administrativ është shprehur tej kërkimeve të kërkuesit. Në këtë kuptim, Kolegji vëren se në paragrafin 18 Kolegji Administrativ ka arsyetuar për kufijtë e shqyrtimit të çështjes prej tij, ndërsa në paragrafin 30 ka arsyetuar vlerësimin e tij për kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata e apelit. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i kundërshtuar nga kërkuesi nuk rezulton të jetë kontradiktor në këto pjesë. Në vlerësimin e Kolegjit, në tërësinë e tij, ai vendim rezulton logjik, i rregullt në formë, i qartë në përmbajtje dhe pjesët përbërëse të tij janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën.

35. Po ashtu, referuar përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë të kundërshtuar nga kërkuesi, Kolegji vëren se ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e tij në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes konkrete. Gjykata e Lartë ka argumentuar mjaftueshëm vendimin e saj, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve për shkakun mbi të cilin palët, përshirë edhe kërkuesin, kanë ushtruar të drejtën e rekursit, që kishte të bënte me ligjin e zbatueshëm mbi bazën e të cilit rregullohej marrëdhënia e punës. Në këtë kuptim, Kolegji evidenton se Gjykata e Lartë e ka përmbushur detyrimin e saj për arsyetimin e vendimit gjyqësor sipas standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

36. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.